

AKT THEMELIMI
I
SHOQËRISË "CERT-AL SOLUTION" SHPK

Në Tiranë, sot më 22.12..2023 (dy mijë e njëzet e tre), në praninë e Ortakëve Themelues të shoqërisë "CERT-AL SOLUTION" SHPK si më poshtë:

1. **Z.Endri DEMO**, i biri i Gjergjit, shtetas shqiptar, i datëlindjes 10.08.1995, lindur në Vlorë dhe banues në Vlorë, me adresë: Rr. "Selam Musai", Nd.10, H1, Vlorë, mbajtës i letërnjoftimit ID me nr. BG7422998 dhe nr.personal J50810148C, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar.
2. **Znj.Joana QELESHI**, shtetase Shqiptare, e bija e Arben, e datëlindjes 07.01.1985, lindur dhe banuese në Tiranë, në adresën: Rruga "Myslym Shyri", Pallati 139, Shkalla 1, Apartamenti 33, Tiranë, mbajtëse e Letërnjoftimit ID me nr.035157355 dhe nr.personal I55107001T, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar.
3. **Znj.Jonida BREÇANI**, e bija e Zaimit, shtetase shqiptare, e datëlindjes 28.12.1997, lindur në Kukës dhe banuese në Tiranë, me adresë Rruga "Artan Lenja", Ish-fusha e Avacionit, Kompleksi IBN, Shkalla 1, Apartamenti20, Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit ID me nr. 033067486 dhe nr.personal J76228052S, madhore e me zotësi të plotë për të vepruar.

Bazuar në nenet 6 e vijues të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (*i ndryshuar*), nënshkruhet ky Akt Themelimi, në të cilin Ortakët Themelues shprehin vullnetin të themelojnë shoqërinë tregtare "CERT-AL SOLUTION" SHPK, me kushtet si vijon:

NENI 1

Emri i shoqërisë

- 1.1. Emri i shoqërisë do të jetë "CERT-AL SOLUTION" SHPK.
- 1.2. Ortakët themelues të shoqërisë gjëzojnë përgjegjësi të kufizuara deri në pjesët respektive të pashlyera të kontributeve të nënshkruara.

NENI 2

Forma e shoqërisë

- 2.1. Forma e shoqërisë "CERT-AL SOLUTION" SHPK (*në vazhdim referuar si "Shoqëria"*) do të jetë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, sipas parashikimeve të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (*i ndryshuar*), derisa të vendoset ndryshe për shndërrimin në një formë tjeter ligjore të parashikuar nga legjislacioni për shoqëritë tregtare.

1

- 2.2. Shoqëria është person juridik privat shqiptar dhe gjëzon personalitet juridik nga data e regjistrimit të saj.

NENI 3

Selia e shoqërisë

- 3.1. Selia e shoqërisë ndodhet në Tiranë, Shqipëri, në adresën: Rruga "Gjin Bue Shpata", Godina Av. Vjetër, Hyrja 7, Ap.34, Kodi Postar 1019.
- 3.2. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose qytet tjeter brenda Republikës së Shqipërisë, si dhe ka të drejtë të hapë degë ose zyra përfaqësimi të saj kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

NENI 4

Kohëzgjatja e Shoqërisë

- 4.1. Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është i pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).
- 4.2. Ortakët e Shoqërisë mund të vendosin kufizimin e afatit të veprimtarisë dhe më pas zgjatjen e tij një apo disa herë, sipas një vendimi të posaçëm.

NENI 5

Objekti i veprimtarisë

- 5.1. Objekti i Veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë, por duke mos u kufizuar në të: *Kryerja e aktivitetit në fushën vlerësimit të konformitetit, duke përfshirë inspektimin, testimin dhe çertifikimin e personave dhe pajisjeve, instalimeve dhe projekteve, në përputhje me legjislacionin në fuqi e licencat, akreditimet dhe miratimet e dhëna nga autoritetet e caktuara me ligj. Pa kufizuar objektin e aktivitetit si më sipër, Shoqëria do të kryejë aktivitete të vlerësimit të konformitetit, të inspektimit, të testimit dhe të çertifikimit të, produkteve (grup-produkteve), pajisjeve dhe instalimeve, por pa u kufizuar, në: enë të thjeshta dhe pajisje nën presion, pajisje të transportueshme nën presion; vinça dhe pajisje ngritëse; makineri, çregullime elektromagnetike dhe pajisje e instalime elektrike; do të kryejë aktivitete të çertifikimit të personave dhe të sistemeve të menaxhimit, kryejë vërtetimë të përputhshmërisë të projekteve, si dhe çdo veprimtari tjetër të lidhur, ndihmëse apo të nevojshme për realizimin e aktiviteteve të pëpermendura më sipër. Veç sa më sipër, shoqëria ka të drejtë të zhvillojë dhe çdo aktivitet tjetër të ligjshëm.*
- 5.2. Shoqëria ka të drejtë të shtojë, pakësojë apo ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi.

NENI 6

Kapitali i Shoqërisë

- 6.1. Kapitali bazë i shoqërisë është në vlerën ALL 100 (njëqind) lekë, i përbërë nga 3 (tre) kuota, ku kuota e zotëruar nga ortaku Endri Demo jep të drejtën e pjesëmarrjes me 60% (gjashtëdhjetë përqind) në kapitalin bazë, si dhe të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë, ku kuota e zotëruar nga ortaku Joana Qeleshi, jep të drejtën e pjesëmarrjes me 25% (njëzet e pesë përqind) në kapitalin bazë, si dhe të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë, ndërsa ortaku Jonida Breçani jep të drejtën e pjesëmarrjes me 15% (pesëmbëdhjetë përqind) në kapitalin bazë, si dhe të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë.
- 6.2. Kuota e ortakut Endri Demo ka vlerë nominale 60 (gjashtëdhjetë) lekë, kuota e ortakut Joana Qeleshi ka vlerë nominale 25 (njëzet e pesë) lekë, dhe kuota e ortakut Jonida Breçani ka vlerë nominale 15 (pesëmbëdhjetë) lekë.
- 6.3. Ortakët Themelues kanë detyrimin të shlyejnë kapitalin bazë të shoqërisë në tërësinë e tij brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e regjistrimit të shoqërisë, ku ortaku Endri Demo do të nënshkruajë dhe paguajë vlerën prej 60 (gjashtëdhjetë) lekë, ortaku Joana Qeleshi do të nënshkruajë dhe paguajë vlerën prej 25 (njëzet e pesë) lekë, dhe ortaku Jonida Breçani, vlerën prej 15 (pesëmbëdhjetë) lekë.

NENI 7

Organet Drejtuese

- 7.1. Bazuar në dispozitat e ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (*i ndryshuar*), organet drejtuese të shoqërisë janë:
 1. **Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve**, e cila është organi më i lartë vendimmarrës;
 2. **Administratori**, i cili është organi ekzekutiv dhe administrativ i Shoqërisë.
- 7.2. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të tyre është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

NENI 8

Administrimi

- 8.1. Shoqëria do të administrohet nga Administratori i saj, i cili mund të zgjidhet për një afat deri në pesë vjet me të drejtë rizgjedhjeje.
- 8.2. Administratori i shoqërisë "CERT-AL SOLUTION" SHPK do të jetë **Z.Endri DEMO**, i biri i Gjergjit, shtetas shqiptar, i datëlindjes 10.08.1995, lindur në Vlorë dhe banues në Vlorë, me adresë: Rr. "Selam Musai", Nd.10, H1, Vlorë, mbajtës i letërnjoftimit ID me nr. BG7422998 dhe nr.personal J50810148C, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar.

8.2.

- 8.3. Administratori emërohet për një afat 3 (tre) vjeçar, me të drejtë riemërimi, duke nisur ky afat nga data e regjistrimit të saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.
- 8.4. Shoqëria do të përfaqësohet përpara çdo organi administrativ, gjyqësor, apo çdo entiteti tjetër publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga Administratori i shoqërisë (apo nga një ose disa persona të autorizuar prej tij), i cili i ushtron të drejtat dhe detyrimet e tij në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi.

NENI 9

Ligji i aplikueshëm

- 9.1. Veprimtaria e Shoqërisë rregullohet nga legjislacioni në fuqi në Republikën e Shqipërisë, ky Akt Themelimi, si dhe parashikimet e Statutit të saj.

NENI 10

Regjistrimi

- 10.1. Shoqëria do të registrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit nga Administratori dhe/ose një/disa person(a) të autorizuar prej tij për këtë qëllim, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

NENI 11

Dispozitat përfundimtare

- 11.1 Ky Akt Themelimi hartohet në 4 (katër) kopje në gjuhen shqipe dhe nënshkruhet nga ortakët e saj themelues.

ORTAKËT THEMELUES
TË
SHOQËRISË “CERT-AL SOLUTION” SHPK

Z. Endri DEMO

Znj. Joana QELESHI

Znj. Jonida BREÇANI

Endri Demo

Joana Qeleshi
Joana Qeleshi

Jonida Breçani
JB